

Ditën e diele Komunitetet fetare organizuan një simpozium për vlerat e familjes, një simpozium që nuk u prit mirë nga komuniteti lgbt, i cili nisi një sulm në media deri sa kërkuan largimin e Kreut të komitetit shtetëror për Kultet. Por çfarë trajtoi simpoziumi, me temë “ Roli i Bashkësive Fetare në forcimin e vlerave të familjes si bërthamë e shoqërisë” Akoma mbetet e pakuptueshme reagimi i lgbt-së ndaj këtij simpoziumi.

Hoxholli në fjalimin e tij për hir të së vërtetës nuk u mor për një sekond të vetëm me ta, biles në një prononcim të tij, shpjegoi se mbetet i cuditur nga reagimi i lgbt-së për arsye se në simpozium u fol vetëm për vlerat, për dhunën ndaj gruas, jetimët, abortin, si edhe orinetimin e shoqërisë në kahun pozitiv. Dhe të flasësh për vlerat e familjes nuk duhet leje nga askush, pasi nuk mendoj se dikush do të ishte kundër.

Për më tepër ne po botojmë fjalën e Hoxhollit për të cilën komuniteti lgbt u deklarua si i fyer dhe kërkoi dorëheqjen duke e quajtur atë fjalim si një homofobi ndaj tyre.

*Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare Të nderuar pjesëmarrës, e nderuara zonja moderatore ... Në fakt, ne jemi mësuar që kur të flasim për familjen, të themi ndal dhunës ndaj gruas, ndal abortit, ndal abandonimit të fëmijëve në jetimore, të themi ndal.. ndal.. ndal... duke u munduar ta ruajmë familjen. Ne mjaftohemi me fjalën “ndal” , shikojmë herë-herë me indiferentizëm dhe ndonjë protestë... Por qasja mbetet gjithmonë në kahun negativ. Ne asnjëherë nuk e kemi pyetur veten se, çfarë humbim ne kur dhunohen gratë? Është një pyetje me që neve na duhet t'i përgjigjemi të gjithë. Në fakt kjo është një pyetje që na fton të shohim nga gjërat e mira që përfitojnë jo vetëm familja, por e gjithë shoqëria, ku një grua nuk është më e dhunuar, por e respektuar... Pikërisht këtu dua të ndalem. Tek ajo që duhet të theksojmë sot më shumë se çdo gjë: tek ato të mira që përfiton shoqëria nga një familje e shëndoshë, nga një familje që në vend të dhunës, propozon buzëqeshje. Që në vend të abortit propozon jetë, ku në vend abandonimit të fëmijës dhuron një brez për një të ardhme të sigurtë... Para disa ditësh isha pranë fëmijëve jetimë biologjik te Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli. Fytyra të qeshura, që dhuronin buzëqeshje dhe dashuri pafund. Fillova të pyes veten, a e dine nënat e tyre se sa bukur u buzëqeshin fëmijët tashmë të rritur... ?? Ne duhet të gjithë së bashku, të bëjmë gjithçka që shoqëria mbarë të jetë e njoftuar nga ato të mira që na vijnë përmes një familjeje në harmoni, në dashuri, në dhembshuri për fëmijët dhe për të tjerët. Ne e dimë se asnjë mekanizëm modern për rehabilitimin e viktimave, nuk mund ta zëvendësojë jetën me dashuri dhe buzëqeshje. Dhe këto të parat gjenden në familjet tona, aty ku ngjizet më pas dashuria për botën përreth.. Ndaj, në një kohë që po shikojmë drejt harresës së vlerave të familjes, me pretekstin se ato tashmë dihen, indiferenca ndaj tyre, ndaj traditës burrë-grua, ndaj edukimit të fëmijëve, të gjitha këto kanë pasojat e tyre në indiferentizmin e gjithë shoqërisë, ndaj unë ju drejtohem ju, si barinj shpirtëror, si përçues të fjalës hyjnore, që të bëjmë gjithçka për të risjellë në vëmendje vlerat dhe modelin e përkryer që kemi brenda nesh, në të kundërt indiferentizmi dhe ashpërsia e shoqërisë do të lërë më pas pasojat tek gjithçka, e sidomos tek e ardhmja. Nëse duam një shoqëri më të mirë, duhet që ajo të orientohet drejt kahut pozitiv, pasi e keqja përhapet nëpërmjet rasteve të këqija, duke na krijuar përshtypjen se ajo tashmë e ka fituar betejën me ne, ndërkohë që orientimi nga e mira, vlerat, e zvogëlon të keqen dhe orienton shoqërinë drejt së mirës... Dhe në këto ditë, kur jemi të pushtuar nga lajmi i keq, ne të gjithë kemi nevojë të vëmë theksin tek e mira. Se nëse kemi një rast dhune diku, kemi qindra e mijëra familje që jetojnë në harmoni. Se nëse ne, do të merremi vetëm me dhunën dhe veset, duke mos vënë theksin tek e mira, do të lëmë hapësirë për të keqen që të prezantohet si normalitet*

*brenda nesh. Ju Faleminderit!!opozita/*